Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

1. Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat e kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për arsye, se gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit Tuaj, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk keni dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme, si është kërkuar në Dosjen e tenderit - SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2. pika 1:

Kërkesat:

³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë përvojë në avancim dhe mirëmbajtje të sistemeve të informacionit të zhvilluara në teknologji Microsoft .NET Core, ASP.NET, JAVA, PYTHON, WEB API, MVC, C#, MS SQL apo të ngjashme, si dhe ndërlidhje me sisteme softuerike, apo aplikacione të ngjashme të realizuara dhe përfunduar me sukses, në tri vitet e fundit të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak së 100,000.00euro

Dëshmia:

1. Lista e projekteve e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte të përfunduara në lëmin e shërbimeve të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referenca procesverbalet e pranimit përfundimtar të shërbimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve.

Je keni dorëzuar liste e projekteve të realizuara mirë po e njëjta nuk plotëson karterët e AK-së të vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit:

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Prandaj për arsyet e cekura më lartë tenderi Juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm.

Ju informojmë së kontrata i është dhënë Tenderuesit, "NOVUS" SH.P.K., Rr. Prishtinë, në vlerë totale të ofertës, në shumë prej 115,115.15 €.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje të punojmë me kompaninë tuaj kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]



**Republika e Kosovës Republika
Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government**

Ministria e Puneve te Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar⁵

Prishtinë: 03.10.2023

Autoriteti Kontraktues: MPB – Divizioni i Prokurimit

Adresa: Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: "DataProgNet" SH.P.K., Rr. Qamil Ilazi, Nr.16, 70000, Ferizaj

Nr. i Prokurimit ⁶	214-23-7918-2-1-1
-------------------------------	-------------------

Titulli: Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)

I/e nderuar(a) _____

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

2. Tenderi i juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat e kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për arsye, se gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit Tuaj, komisioni i vlerësimit ka konstatuar se nuk keni dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të

⁵ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtejshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

mjaftueshme, si është kërkuar në Dosjen e tenderit - SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) (Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2. pika 2:

Kërkesat:

2. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë Një (1) Menaxher të projektit i cili duhet të ketë Diplome universitare në Shkenca Kompjuterike ose ekuivalente - min. 5 vjet përvojë punë pas diplomimit në menaxhim të projekteve dhe zhvillim të aplikacioneve, të jetë i certifikuar në PMP ose ekuivalent.

Dëshmia:

2. Për menaxherin e Projektit të paraqiten Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, Certifikata ose Diploma për PMP ose ekuivalent - kopje, CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), Vendim për caktimin e menaxherit të projektit i nënshkruar dhe vulosur nga punëdhënësi- kopje, Referencat për përvojën e punës dhe referenca për punët e mëparshme për mbikëqyrje në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit, që duhet të përmbajnë titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilat lëshohet referenca.

Ju nuk keni dorëzuar fare asnjë stafe për këtë pikë, prandaj për arsyet e cekura më lartë tenderi Juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e më tutjeshëm.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë Tenderuesit, "NOVUS" SH.P.K., Rr. Prishtinë, në vlerë totale të ofertës, në shumë prej 115,115.15 €.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe pse nuk kemi qenë në gjendje të punojmë me kompaninë tuaj kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

_____,
[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]



Republika e Kosovës Republika
Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Puneve te Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department of Procurement

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm⁷

Prishtinë: 03.10.2023

Autoritetit Kontraktues: **MPB – Divizioni i Prokurimit**

Adresa: Rr: “Luan Haradinaj”, pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, Prishtinë

Adresa e tenderuesit: “NOVUS” SH.P.K., Rr. Tirana nr.31, kati 6, 10000, Prishtinë

Nr. i Prokurimit⁸

214-23-7918-2-1-1

Titulli: **Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)**

I/e nderuar(a) [Z/Znj]] _____]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës për aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj në shumë prej 115,115.15€ dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadim të intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Me respekt,

[Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]

[Nënshkrimi]

⁷Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata

Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.

KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTACION

Nga: **DataProgNet SH.P.K.**

Për: **Ministria e Punëve të Brendshme**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **214-23-7918-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)**

Konform ligjit të KRPP-së kërkojm qasje zyrtare në dokumente të OE, "NOVUS" SH.P.K, të propozuar si tenderues të suksesshëm.

Enver Shabani
Drejtör i përgjithshëm



Datë: 05.10.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs
Departamenti i Prokurimit / Departmanza Javnu Nabavku / Department of Procurement

Data: 09.10.2023

Aprovim i kërkesës për qasje në Dokumente të AP-së

E/I nderuar,

Konform kërkesës tuaj në harmoni me Nenin 10 të LPP-në, mund të keni qasje të plotë nga ky moment me datën 09/10/2023 lidhur me AP-në me Titulli: **"Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)" dhe nr. të prokurimit: "214-23-7918-2-1-1** Adr. Rr: "Luan Haradinaj", pn, ndërtesa qendrore e MPB-së, kati II, zyra 204, Prishtinë.

Me respekt,
Departamenti i Prokurimit / MPB

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **214-23-7918-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

DataProgNet SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga "Qamil Ilazi" nr. 16

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383(0)49789661

-

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Enver Shabani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@dataprognet-ks.com

(Adresa elektronike)

09.10.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)



Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokanit)

(Adresa e plotë)

(Numri i telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e paraqitjes së kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

(Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin e tërësive publike. Njoftim për kontratë apo "Njoftim për konkurs të projektimit", dhe nëse aplikohet "Njoftim për dhënie të kontratës", "Njoftim për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi i anulimit dhe refuzimit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për hapjes së tenderëve, si dhe kriterin për dhënie të kontratës.)

1. Njoftim për kontratë, publikuar në KRPP, më datë 03.08.2023
2. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 08.08.2023
3. Njoftim për Proces verbal i hapjes së Tenderëve më 14.09.2023
4. B58 - Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues 04.10.2023
5. Kërkesë për qasje në dokumentacion nga DataProgNet SH.P.K. 05.10.2023
6. Aprovim i Kërkesës për Qasje 09.10.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesin e hapjes së tenderit e kemi pranuar përmes platformës elektronike <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit?

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (RrPP). Në vijim po paraqesim rrethanat, faktet dhe argumentet për shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe RrPP-së.

- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne pretendojmë se është shkelur Neni 59 për Ekzaminim, Vlerësim dhe Krahësim të Tenderëve i LPP-së, pasi që komisioni i vlerësimit të ofertave nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MPB nuk ka trajtuar ofertat e OE-ve sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP-së.

Ju njoftojmë se OE Novus sh.p.k. i shpërblyer me dhënie të kontratës, nuk i plotëson “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2” siç janë kërkuar në dosjen e tenderit:

1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë përvojë në avancim dhe mirëmbajtje të sistemeve të informacionit të zhvilluara në teknologji Microsoft .NET Core, ASP.NET, JAVA, PYTHON, WEB API, MVC, C#, MS SQL apo të ngjashme, si dhe ndërlidhje me sisteme softuerike, apo aplikacione të ngjashme të realizuara dhe përfunduar me sukses, në tri vitet e fundit të gjitha së bashku në vlerë prej jo më pak se 100,000.00euro.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e projekteve të nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte të përfunduara në lëmin e shërbimeve të ngjashme (nga Njoftim për Kontratë për periudhë të shkurtër trevjeçare), duke bashkëngjitur referenca procesverbalet e pranimit përfundimtar të shërbimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve.

Të gjeturat me arsyet e mos plotësimit të kësaj kërkesë – shkelja e Neni 59 të LPP-së:

OE Novus sh.p.k. në ofertën e dhënë ka dorëzuar listën prej 12 projekteve, por asnjëri nga këto 12 projekte nuk i plotësojnë kriteret për të u marrë për bazë si projekte të ngjashme me projektin e “Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)” që kërkohej të mirëmbahet dhe përditësohet nga AK-MPB, me arsyet dhe sqarimet me fakte për secilin projekt që kemi dhënë si në vijim:

1. Projekti me titull “Support to Koosvo Veterinary and Food Agency (KVFA) in upgrading and functionalization information technology systems and increasing its capacity to implement an integrated approach to food safety, EuropeAid/139701/DH/SER/XK”, sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij

Novus sh.p.k. ende nuk është përfunduar dhe nuk mund të merret si referencë, pasi që data e përfundimit të këtij projekti është 28/10/2023. Dëshmia e lëshuar nga **“European Union”** dëshmon vlerën që kanë paguar deri më tani **“European Union”** koncertiumit për këtë projekt e jo referencën e përfundimit të projektit siç është kërkuar në dosjen e tenderit”.

2. Projekti me titull **“Sistemi i integruar informative bujqësor (SIIB)”**, sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij OE Novus sh.p.k. nuk mund të merret për bazë, pasi që nuk është realizuar në tri vitet e fundit nga data e dorëzimit të ofertave sipas ligjit të KRPP-së.
3. Projekti me titull **“Mbledhja e të dhënave për Rrjetin e Kontabilitetit në Fermë - FADN”**, sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij Novus sh.p.k. nuk mund të merret për bazë, pasi që nuk është realizuar në tri vitet e fundit nga data e dorëzimit të ofertave sipas ligjit të KRPP-së. Ky projekt ka të bëjë me anketa dhe grumbullimin e të dhënave dhe nuk i plotëson kriteret për të u marrë për bazë si projekt i natyrës së ngjashme bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.
4. Projekti me titull **“Government Gateway Interoperability Platform”**, sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij OE Novus sh.p.k. nuk mund të merret për bazë, pasi që nuk është realizuar në tri vitet e fundit nga data e dorëzimit të ofertave sipas ligjit të KRPP-së (shih datat e lëshuara të dy Referencave me 15.02.2020 dhe me January 2020 !!!!!!!). Dy referenca të lëshuara me data të ndryshme nga Ministria e Administratës Publike për të njëjtin projekt, ende pa u përfunduar kontrata e nënshkruar në Qershor (June) 2017 për 36 muaj).
5. Projekti me titull **“Development of an Irrigation Master Plan and Investment Framework for Kosovo, Contratat no. KARP-CS-6(i)”**, sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij OE Novus sh.p.k. nuk mund të merret për bazë, pasi që nuk është realizuar në tri vitet e fundit nga data e dorëzimit të ofertave sipas ligjit të KRPP-së.
6. Projekti me titull **“Suport for the Promorion and Imlemetation of the Public Administration Modernization Agenda (MPZAMAP)”**, sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij Novus sh.p.k. nuk mund të merret për bazë sipas ligjit të KRPP-së, pasi që OE Novus sh.p.k. nuk ka dorëzuar reference për këtë projekt. Po ashtu, ky projekt nuk i plotëson kriteret për të u marrë për bazë si projekt i natyrës së ngjashme me projektin **“Sistemi i Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)”** bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.
7. Projekti me titull **“Mobile Application “InfluApp”**”, bazuar në përshkrimin e projektit dhe sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij OE Novus sh.p.k. nuk mund të merret për bazë sipas ligjit të KRPP-së, pasi që OE Novus sh.p.k. ka dorëzuar reference se **“ky projekt është zhvilluar në platformën mobile”** e jo në Ueb siç është kërkuar në dosjen e tenderit: *“Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë përvojë në avancim dhe mirëmbajtje të sistemeve të informacionit të zhvilluara në teknologji Microsoft .NET Core, ASP.NET, JAVA, PYTHON, WEB API, MVC, C#, MS SQL apo të ngjashme, si dhe ndërlidhje me sisteme softuerike, apo aplikacione të ngjashme të realizuara dhe përfunduar me sukses, në tri vitet e fundit të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak së 100,000.00euro”*. Po ashtu, ky projekt nuk i plotëson kriteret për të u marrë për

bazë si projekt i natyrës së ngjashme me projektin “Sistemi i Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)” bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.

8. Projekti me titull “**Aplikacioni mobil për menaxhimin e trasaksioneve të blerjeve të pompave të benzinës**”, bazuar në përshkrimin e projektit dhe sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij Novus sh.p.k. nuk mund të merret ky projekt për bazë sipas ligjit të KRPP-së, pasi që OE Novus sh.p.k. ka dorëzuar reference se “**ky projekt është zhvilluar në platformën mobile**” e jo siç është kërkuar në dosjen e tenderit: “*Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë përvojë në avancim dhe mirëmbajtje të sistemeve të informacionit të zhvilluara në teknologji Microsoft .NET Core, ASP.NET, JAVA, PYTHON, WEB API, MVC, C#, MS SQL apo të ngjashme, si dhe ndërlidhje me sisteme softuerike, apo aplikacione të ngjashme të realizara dhe përfunduar me sukses, në tri vitet e fundit të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak së 100,000.00euro*”. Po ashtu, ky projekt nuk i plotëson kriteret për të u marrë për bazë si projekt i natyrës së ngjashme me projektin “Sistemi i Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)” bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.
9. Projekti me titull “**Zhvillimi i plikacionit mobil për lajme dhe seksionin e sondazheve**”, bazuar në përshkrimin e projektit dhe sipas të dhënave që ka prezantuar në ofertë e tij OE Novus sh.p.k. nuk mund të merret ky projekt për bazë sipas ligjit të KRPP-së, pasi që OE Novus sh.p.k. ka dorëzuar reference se “**ky projekt është zhvilluar në platformën mobile**” e jo siç është kërkuar në dosjen e tenderit: “*Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë përvojë në avancim dhe mirëmbajtje të sistemeve të informacionit të zhvilluara në teknologji Microsoft .NET Core, ASP.NET, JAVA, PYTHON, WEB API, MVC, C#, MS SQL apo të ngjashme, si dhe ndërlidhje me sisteme softuerike, apo aplikacione të ngjashme të realizara dhe përfunduar me sukses, në tri vitet e fundit të gjitha së bashku në vlerë prej jo me pak së 100,000.00euro*”. Po ashtu, ky projekt nuk i plotëson kriteret për të u marrë për bazë si projekt i natyrës së ngjashme me projektin “Sistemi i Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)” bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.
10. Projekti me titull “**Organic Records Management System**”, bazuar në të dhënat që ka prezantuar në ofertë e tij OE Novus sh.p.k. tek lista e projekteve, nuk mund të merret ky projekt për bazë sipas ligjit të KRPP-së, pasi që nuk është i përfunduar ende. Sipas të dhënave në listën e projekteve që ka prezentuar OE Novus sh.p.k., ky projekt do të përfundon me 31.12.2024 dhe nuk ka dorëzuar (bashkëngjitur) Referencë apo procesverbalin e pranimi përfundimtar të shërbimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projektit, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.
11. Projekti me titull “**Mirëmbajtja dhe avancimi i Sistemit aktual të Intranetit të Komunave-SIK**”, bazuar në të dhënat që ka prezantuar në ofertë e tij Novus sh.p.k. tek lista e projekteve, nuk mund të merret ky projekt për bazë sipas ligjit të KRPP-së, pasi që nuk është i përfunduar ende. Sipas të dhënave në listën e projekteve që ka prezantuar OE Novus sh.p.k., ky projekt do të përfundon me 22.08.2025 dhe nuk ka dorëzuar (bashkëngjitur) Referencë apo procesverbalin e pranimi përfundimtar të shërbimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projektit, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

12. Projekti me titull **“Request for Proposals: develop The Workflow Mapping, Wireframing And Software Requirements Specification for the Electronic Case Management System of the Labour Inspectorate of Kosovo”**, bazuar në të dhënat që ka prezantuar në ofertë e tij OE Novus sh.p.k. tek lista e projekteve, nuk mund të merret ky projekt për bazë sipas ligjit të KRPP-së, pasi që nuk është i përfunduar ende. Sipas të dhënave në listën e projekteve që ka prezantuar OE Novus sh.p.k., ky projekt do të përfundon me 30.09.2023 dhe nuk ka dorëzuar (bashkëngjitur) Referencë apo procesverbalin e pranimit përfundimtar të shërbimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projektit, siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

OE Novus sh.p.k. nuk i plotëson as **“Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2”** siç janë kërkuar në dosjen e tenderit:

3. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të ketë mini. **Dy (2) Zhvillues të softuerit** - (në teknologji të Microsoft - .NET, SQL Server etj.) Diplome universitare në Shkenca Kompjuterike ose ekuivalente, min. 3 vjet përvojë punë pas diplomimit në zhvillimin të aplikacioneve softuerike.

3. Për zhvilluesit - Diploma përkatëse e motorizuar nga origjinali, CV, kontrata e punës valide ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt me punëdhënësin - kopje, Referencat për përvojën e punës dhe referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit që duhet të përmbajnë titullin e projektit, vlerën e projektit, vendin e ekzekutimit të projektit për të cilat lëshohet referenca.

Fakte dhe të gjeturat për Synim Selimi të propozuar për pozitën “Zhvillues të softuerit”:

- Kërkojmë nga OSHP të vërtetohet se a ka punuar në kompaninë Novus sh.p.k. z. Synim Selimi, pasi që në CV-në që ka dorëzuar Novus sh.p.k. për Synim Selimi, qartë kuptohet se Synim Selimi nuk ka punuar në kompaninë Novus sh.p.k., ndërsa Drejtoresha Përgjithshme e Novus sh.p.k. Leonora Memetaj Hajdini lëshon një Letër Rekomandimi, ku konfirmon se Synim Selimi ka 7 vite eksperiencë në Zhvillim Softueri në projektet e realizuara dhe në realizim të kompanisë Novus sh.p.k. (gjatë viteve 2017-2021), për çudi referenca ka vulë dhe nënshkrim, por nuk ka datë të lëshimit siç duhet të ketë çdo reference e lëshuar.

Mbetet nga OSHP të vërtetohet ky fakt i gjetur në ofertën e OE Novus sh.p.k. dhe të merren masa sipas ligjit.

• Gjithashtu ju njoftojmë se **“Sistemi i Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)”** e ka zhvilluar dhe mirëmbajtur kompania DataProgNet SH.P.K.. Gjatë periudhës së zhvillimit, avancimit dhe mirëmbajtjes, nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga Institucionet e Republikës së Kosovës (IRK-të), ku ju kemi përkushtuar në maksimum dhe seriozitet të lartë profesional. Nga ish Ministria e Administratës Publike (MAP) pas përfundimi të këtij sistemi posedojmë Referencë POZITIVE.

Pasi që kemi pasur qasje zyrtare konform Ligjit të KRPP-së në ofertën teknike që ka dhënë OE Novus sh.p.k. dhe pasi që kemi lexuar dhe analizuar me kujdes propozimin teknik për mirëmbajtjen dhe përditësimi në e këtij sistemi, e kemi kuptuar se ky operator ekonomik nuk e ka të qartë natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e këtij shiti shumë të rëndësishëm për të gjitha IRK-të e Republikës së Kosovës.

- Bazuar në këto fakte oferta teknike që ka dhënë OE Novus sh.p.k. nuk i plotëson kërkesat e **“ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME”** për **“MIRËMBAJTJA DHE PËRDITËSIMI I SISTEMIT PËR MENAXHIMIN DHE ARKIVIMIN ELEKTRONIK TË DOKUMENTEVE”**.

Prandaj, duke u bazuar nga faktet dhe argumentet e lartpërmendura, ne kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues "Ministria e Punëve të Brendshme" që të rishqyrtohet vendimi i datës 04.10.2023 për dhënie të kontratës OE Novus sh.p.k., pasi që nuk i plotëson kriteret sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe lënda të rikthehet në RIVLERSIM apo nëse nuk plotëson kriteret për shpërbllim me kontratës asnjëri nga OE-të pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit i tërë aktiviteti të shkon në RITENDERIM.

Nëse nuk merren për bazë faktet e paraqitura më lartë gjatë kërkesës sonë për rishqyrtim, jemi të obliguar që brenda afateve ligjore të dorëzojmë ankesën në OSHP.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demi material i përgatitjes së ofertës si dhe dëmet tjera do të pasqyrohen pas një analize gjyqësore përfshirë kompensimi i fitimit të humbur.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura


Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1. Njoftim për kontratë, publikuar në KRPP, më datë 03.08.2023*
- 2. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara 08.08.2023*
- 3. Njoftim për Proces verbal të hapjes së Tenderëve më 14.09.2023*
- 4. B58 - Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues 04.10.2023*
- 5. Kërkesë për qasje në dokumentacion nga DataProgNet SH.P.K. 05.10.2023*
- 6. Aprovim i Kërkesës për Qasje 09.10.2023*



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

DATË/A:	11.10.2023
REFERENCE:	
PËR/ZA/TO:	Grup i Operatorëve Ekonomik "DataProgNet SH.P.K."
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	e-prokurimit
NGA/OD/FROM:	Agim ISLAMI,  Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit -MPB
TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim, për Aktivitetin e prokurimit, "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me nr. të prokurimit : 214-23- 7918-2-1-1

Ministria e Punëve të Brendshme, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Tenderuesit, "DataProgNet SH.P.K." Prishtinë Rr. Qamil Ilazi, Nr. 16 Vendi Ferizaj , të datës 09.10.2023 në ora 23:45 lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me nr. të prokurimit : 214-23-7918-2-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, mbështetur në Ligjin nr. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP), neni 108/A, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtim të Tenderuesit "DataProgNet SH.P.K." Prishtinë Rr. Qamil Ilazi, Nr. 16 Vendi Ferizaj, e pa afatshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me nr. të prokurimit : 214-23-7918-2-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të publikuar me datë 03.10.2023.
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK i publikuar me 03.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me nr. të prokurimit : 214-23-7918-2-1-1

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimi të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore- Tenderuesi "DataProgNet SH.P.K." Prishtinë Rr. Qamil Ilazi, Nr. 16 Vendi Ferizaj.

Në zbatim të, LPP-së Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerrë këtë përfundim: KËRKESA PËR RISHQYRTIM, Refuzohet e PA-AFATSHME.

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimi të Kërkesës për rishqyrtim, të Tenderuesit "DataProgNet SH.P.K." Prishtinë Rr. Qamil Ilazi, Nr. 16 Vendi Ferizaj, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi me 03.10.2023, e ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore dhe ka konstatuar se Kërkesa për rishqyrtim është e PA AFATSHME, është në kundërshtim me Nenin 108/A të LPP-së pika 3.2, dhe neni 5 të LPP-së.

Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore i LPP-së

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit.

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

është në kundërshtim me nenin 60 pika 1. b, të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

pasi që nuk është dorëzuar brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik.

Konkluzion:

1. REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtim e Tenderuesit "DataProgNet SH.P.K." Prishtinë Rr. Qamil Ilazi, Nr. 16 Vendi Ferizaj, e pa AFATSHME, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK, për tenderin "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe

Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me nr. të prokurimit : 214-23-7918-2-1-1.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi vendimin e AK i publikuar me 22.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me nr. të prokurimit : 214-23-7918-2-1-1.

III. Ministria e Punëve të Brendshme, vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me nr. të prokurimit : 214-23-7918-2-1-1.

Ministria e Punëve të Brendshme nga provat e prezantuara me lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Tenderuesit "DataProgNet SH.P.K." Prishtinë Rr. Qamil Ilazi, Nr. 16 Vendi Ferizaj
2. Platformë elektronike: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/> e MPB-ës.

Kërkesë për aprovim dhe shqyrtim të Kërkesës për Rishqyrtim per projektin me Titull "për: Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) dhe Nr. Prokurimi: 214-23-7918-2-1-1

1 message

DataProgNet Info <info@dataprognet-ks.com>

Thu, Oct 12, 2023 at 1:17 PM

To: Agim Islami <Agim.Islami@rks-gov.net>, Armend Rugova <Armend.Rugova@rks-gov.net>, Fatmir Thaqi <fatmir.thaqi@rks-gov.net>

Përshëndetje i nderuar drejtor i Prokurimit z. Islami

Përshëndetje të nderuar z. Rugova dhe z. Thaqi,

Ju njoftojm se bazuar në vendimin e pranuar per projektin me Titull "për: Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) dhe Nr. Prokurimi: 214-23-7918-2-1-1 nga MPB përms B45 – Letër standarrde për tenderusin e suksesshë me datë: 04.10.2023, (OE NOVUS SH.P.K), kompania DataProgNet SH.P.K. ka bër kerkesë për qasje ne dokumentacion me datë: 05.10.2023, ku në bazë të LPP-së Kërkesën për Rishqyrtim e kemi bërë mbrenda afateve ligjore.

Sic jeni në dijuni dhe bazuar në faktet e emailave të shkëmbyer dhe në takimin e mbajtur në mes përgaqsuesit të DataProgNet SH.P.K. dhe Zyrtarit të Prokurimit nga MPB z. Armen Rugova, është konsttuar nga z. Rugova se me vonesë e kan pare ne systemin eProkurimin Kërkesën tone për Rishqyrtim, po në të njejtën ditë me datë 09.10.2023 ju kemi njoftuar edhe përmes emailit per arsyeje se nuk kemi marr përgjigjje ne sistemin e E-Prokurimit.

Zyrtari i autorizuar nga DataProgNet SH.P.K është takuar ne zyret përkatse prokurimit të AK-së me date 09.10.2023, ku personin përgjëgjës z. Rugova jemi njoftuar në takim se ka pas probleme në sistemin e-Prokurimit dhe per këtë arsye është vonuar edhe aprovimi i kërkesës së OE DataProgNet SH.P.K., po në këtë date me 09.10.2023 na është lejuar qasje në dokumente e OE të shpërblyer me kontratë dhe po në këtë date Brenda afatev ligjore kemi dorëzuar në sistemin eProkurimi Kërkesën për Rishqyrtim.

Edhe pse kemi dorëzuar brenda afatit gjorë Kërkesën për Rishqyrtim me datë 09.10.2023 përmes sistemit të e-Prokurimit, nuk e kemi të qartë pse me me date 11.10.2023 jemi njoftuar nga AK me vendimi se Kërkesës për Rishqyrtim na është refuzuar për arsye se kërkesa është e pa afatshme për projektin me titull: " Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED) ", me numer prokurimit: 214-23-7918-2-1-1.

Ju lutemi që të merrni për bazë faktet e paraqitura më lartë dhe ta shqyrtoni Kërkesën për Rishqyrtim, që të mos ju drejtohem iistancave tjera ligjore, apo të obligohemi ta dorëzojmë lëndën në OSHP.

Faleminderit për mirkuptim dhe shpresojm që ta merrni për bazë këtë kërkesë!

Enver Shabani,
Drejtor i pergjithshem
DataProgNet SH.P.K.

631504498 14.10.2023 12:58:19

Pagesë e faturave / Bill Payments

Nr. i llogarisë / Account No: XK051170179541000154
Emri i llogarisë / Account name: DATAPROGNET SHPK
Emri tregtar / Commercial name: DATAPROGNET SHPK
Kodi Utilitar / Utility Code: 20 Komisioni Rregullativ i Prok.Publik -1000430070005756
Referenca e pagesës / Payment reference: PPQDD1111111111H Ankesë
për lëndën me Nr i prokurimit:
214-23-7918-2-1-1 me Titull:
Mirëmbajtja dhe Përditësimi i
Sistemit të Menaxhimit dhe
Arkivimit Elektronik të
Dokumenteve (SMAED)
Shuma / Amount: 1,189.44 EUR
Provizioni / Commission: 0.80
Shuma totale / Total amount: 1,190.24
Data / Date: 14.10.2023
Pershkrimi i pagesës / Payment description: Organi i Shyrtues i Prokurimit (OSHP)

CONFIRMED

Date: 14.10.2023

**ProCredit Bank**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY



UNIREF

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT



PPQDD1111111111H

Të dhënat e OE
Podaci EO
EO data

DataProgNet SH.P.K

Përshkrimi
Opis
Description

Ankesë për projektin me titull: "Mirëmbajtja dhe Përditësimi i Sistemit të Menaxhimit dhe Arkivimit Elektronik të Dokumenteve (SMAED)"

Numri i prokurimit
Broj nabavke
Procurement number

214-23-7918-2-1-1

Shuma / Iznos
Amount

€ 1 1 8 9 Euro 4 4 Ct Data/ Datum/ Date 1 4 1 0 2 3

Me fjalë / Rečima
In words

Njëmijë e Njëqind e Tetëdhjetë e Nëntë Euro e Katërdhjetë e Katër Cent

Xhirollogaria
Broj žiroračuna
Bank account

1 0 0 0 4 3 0 0 7 0 0 0 5 7 5 6

Lëshuar nga
Izdato od /
Issued by

OSHP

E Paguar me e-Banking

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 të LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP.

a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërblim të një kontrate, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.

b. Kurdo që aneksa ndërlihet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës së ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000Euro.

14.2U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN.

a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €.

b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.